



REPUBLICA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Primjenol/Prodato Received / Delivery	07-04-2023	3 viti god vegr.	
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot. No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIM&UC	3447/2023		1/5



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.438/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtare me Sabile Avdyli Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.438/2023 të datës 01.03.2023 të parashtruar nga ankuesi me adresë në çështjen juridike "kontestim konkursi" kundër organit të punësimit Komuna e Vushtrrisë, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 07.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.438/2023 e datës 01.03.2023 e parashtruar nga ankuesi
- II. Anulohet konkursi i datës 20.12.2022 sipas numrit të referencës RN00010647 për emrin e grupit "Specialistë i Administrimit të Përgjithshëm" për pozitën Inspektor i Shërbimeve Publike (Profesional 1), i shpallur nga Komuna e Vushtrrisë si dhe shfuqizohen të gjitha vendimet që rrjedhin nga kjo procedurë e rekrutimit.
- III. Obligohet Udhëheqësi i Personelit të Komunës së Vushtrrisë, që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore, me qëllim të zbatimit të këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Komuna e Vushtrrisë duke u bazuar në dispozitat e nenit 34 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publike dhe të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të

Republikës së Kosovës, me datën 20.12.2022 ka njoftuar lidhur me shpalljen e konkursit me emër grupi "Specialist i Administrimit të Përgjithshëm" me numër reference RN00010647 për pozitën "Inspektor i Shërbimeve Publike"(Profesional 1), pranë Drejtorisë për Inspektime në Komunën e Vushtrrisë, afati për aplikim prej datës 10.01.2023 deri më datë 24.01.2023.

Ankuesi ka aplikuar në konkursin me emër grupi " Specialist i Administrimit të Përgjithshëm "me numër reference RN00010647 për pozitën "Inspektor i Shërbimeve Publike"(Profesional 1) pranë Drejtorisë për Inspektime në Komunën e Vushtrrisë në të cilën procedurë ka qenë i përfshirë vetëm në fazën e verifikimit paraprak sepse Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Vushtrrisë me vendimin me numër protokoli 5565/23 të datës 02.02.2023 i refuzon aplikacionin me arsyetim për mos plotësim të kërkesave të përgjithshme të konkursit të lartë cekur.

I pa kënaqur me vendimin e lartë cekur për mos përfshirje në listën e ngushtë, ankuesi ka parashtruar ankesë tek Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Vushtrrisë, ndërsa kjo e fundit me datën 06.02.2023 ka nxjerrë Vendimin me Nr.6229/23 sipas të cilit e ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar.

Ankuesi i pa kënaqur me vendimin Nr.6229/23 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Vushtrrisë lidhur me refuzimin e ankesës se tij, me datën 01.03.2023, ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 438/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për shkelje esenciale të dispozitave ligjore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës konform dispozitave të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datën 07.03.2023 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Vushtrrisë, ndërsa kjo e fundit me datën 15.03.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Vushtrrisë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e parashtruar nga ankuesi me numër 2208/2023 të datës 01.03.2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin për rezultatet përfundimtare të vlerësimit me numër protokoli 8405/23 të datës 21.02.2023; Njoftimi i shpalljes së konkursit me numër reference RN00010647 për pozitën Inspektor i Shërbimeve Publike me datë 20.12.2022; Vendim i lëshuar nga Komuna e Vushtrrisë me numër protokoli 5565/23 të datës 02.02.2023; Vendim i lëshuar nga Komuna e Vushtrrisë me numër protokoli 6229/23 të datës 06.02.2023; Njoftim për verifikimin paraprak me numër protokoli 5671/23 të datës 02.02.2023; Njoftim i lëshuar nga Komuna e Vushtrrisë me numër protokoli 6248/23 të datës 06.02.2023; Rregullorja (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil; Vërtetim i lëshuar nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë me datë 22.01.2020; Vërtetim i lëshuar nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë me datë 03.10.2019; Pasqyra e llogarisë së trustit për periudhën 02.01.2013 deri më 31.01.2023; Njoftimi i shpalljes së konkursit me numër reference RN00010499 të datës 25.11.2022; Njoftim për verifikimin paraprak me numër protokoli 2987/23 të datës 18.01.2023; Njoftim për verifikimin përfundimtar paraprak me numër protokoli 3694/23 të datës 23.01.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë me numër protokoli 2465/2023 të datës 07.03.2023;

Përgjigje në ankese me numër protokollit 12392/23 të datës 15.03.2023; Aplikacioni i datës 23.01.2023 i ankuesit së bashku me përgatitjen profesionale dhe atë të përvojës së punës; Diplomë e Shkollës "Eqrem Çabej" për me numër protokollit 305 të datës 12.06.2006; Diplome e Universitetit të Prishtinës- Fakulteti i Xehetarisë dhe Metalurgjisë në Mitrovicë me numër 198 të datës 27.02.2012; Diplomë e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina"- Fakulteti i Xehetarisë dhe Metalurgjisë në Mitrovicë në drejtimin Master i Shkencave Teknike me numër 152 të datës 22.10.2014; Certifikatë me numër 145/2015 e datës 12.05.2015; Certifikatë me numër 293/2015 të datës 31.07.2015; Certifikatë me numër 315/16; Certifikatë me numër 136/2016 e datës 15.04.2016; Certifikatë e datës Gusht 2019; Certifikatë 27.12.2022; Certifikatë e datës tetor 2013; Vërtetim i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë me datë 22.01.2020; Vërtetim i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë me numër protokollit 5639 të datës 03.10.2019; Pasqyra e llogarisë së Trustit e periudhës 16.10.2013-18.01.2023; Pasqyra tremujore e tatimit dhe kontributeve për bizneset e vogla individuali të ; Vërejtje e ; Referencë e lëshuar nga IADK me nr.58/2020 të datës 20.10.2020; Vërtetim i marrëdhënies së punës i lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë për me datë 23.12.2022; Certifikatë e datës 31.07.2015; Rekomandim për nga Letër reference nga IADK me nr.58/20 të datës 20.10.2020; c Letërnjoftim i ; Ekstrakt i me nr.E 90163246 të datës 19.02.2019; Certifikatë mbi dënimet penale lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës me datës 20.12.2022; Kërkesë për plotësimin e pozitave të lira në Drejtorinë për Inspektime me 13 nr.423/2022 të datës 20.12.2022; Shpalljen e konkursit me numër reference RN00010647 me emër grupi Specialist i Administrimit të Përgjithshëm me datë 20.12.2022; Vendim me nr.110/23 të datës 02.02.2023 i lëshuar nga Komuna e Vushtrrisë; Akt emërim për me nr.02-112-1043 të datës 07.02.2013; Akt emërim për me nr.08/13 të datës 09.01.2013; Akt emërim për me AE.nr.20-035/01-0017003/22 të datës 01.04.2022; Akt emërim për me nr. 700 të datës 25.01.2011; Marrëveshje mes Komunës së Vushtrrisë dhe R.K me nr.02/23 të datës 05.01.2023; Vendim me numër 5565/23 të datës 02.02.2023; Pasqyra e llogarisë së Trustit për për periudhën 02.01.2013 deri më 31.01.2023; Lista e aplikantëve për konkursin RN00010647; Njoftim me numër protokollit 7872/23 të datës 16.02.2023; Renditja përfundimtare e kandidatëve; Njoftim me numër 8405/23 të datës 21.02.2023;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e bazuar, sepse:

Pasi i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit si dhe të gjitha provat e lëndës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se kriteret e konkursit për emrin e grupit "Specialist i Administrimit të Përgjithshëm", në Komunën e Vushtrrisë, i shpallur sipas konkursit me numër të referencës RN00010647 për pozitën "Inspektor i Shërbimeve Publike"(Profesional 1) pranë Drejtorisë për Inspektime në Komunën e Vushtrrisë, kanë qenë si në vijim:

- *Arsimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to.*
- *Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 3 (tri) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së shpalljes së konkursit dhe zhvillimit të procedurave të rekrutimit deri në fazën kur ankuesi ka parashtruar ankesë, ka analizuar dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e

Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, konkretisht tek shtojca Nr.1/6, Klasa e grupit 1 të kësaj rregullore janë përcaktuar kriteret lidhur me fushën e kërkuar të arsimit dhe të përvojës së punës për secilën kategori të shërbimit civil, konkretisht për emrin e grupit "*Specialist i Administrimit të Përgjithshëm*" përvoja e kërkuar sipas kësaj Rregullore është 2 (dy) vite përvojë pune, ndërsa tek kërkesat e përgjithshme formale të konkursit me numër reference RN00010647 të shpallur me datën 20.12.2022, me emër grupi "*Specialist i Administrimit të Përgjithshëm*" nga Komuna e Vushtrrisë, përvoja e punës e kërkuar është 3 (tri) vite , andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit ka konstatuar se me rastin e mos përcaktimit të përvojës së duhur si kriter të konkursit të lartë cekur siç përcaktohet me dispozitat e kësaj rregullore, Komuna e Vushtrrisë ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik neni 6 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: "*Pranimi në detyrë i nëpunësit civil, nëpunësit të Shërbimit Publik dhe nëpunësit administrativo-teknik dhe mbështetës, bazohet në parimet e mundësive të barabarta, meritës dhe integritetit, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe proporcional gjinor dhe të komuniteteve. 2. Pranimi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës profesional, transparent e të drejtë, që garanton mundësi të barabarta për kushte të barabarta dhe përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar për kryerjen e detyrave përkatëse, duke garantuar përfaqësim minimal të komuniteteve dhe të gjinive*" si dhe në kundërshtim me dispozitat e Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës konkretisht nenin 4 paragrafin 2 ku përcaktohet se: "*Parimet e pranimit dhe avancimit në karrierë: Nëpunësit civil pranohen dhe avancohen në karrierë në bazë të meritës të vlerësuar në bazë të një procedure konkurruese dhe transparente, të përcaktuara në bazë të Ligjit dhe akteve përkatëse nënligjore*".

Andaj, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë si dhe analizimit të dispozitave ligjore lidhur me kushtet dhe kriteret e pranimit në shërbimin civil, duke marrë për bazë edhe konstatimet e pasqyruara si në arsyetimin e këtij vendimi, ka konstatuar se konkursi i shpallur me datën 20.12.2022 sipas numrit të referencës RN00010647 për emrin e grupit "*Specialist i Administrimit të Përgjithshëm*" nga Komuna e Vushtrrisë është bërë në kundërshtim me nenin 4 paragrafin 2 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe në kundërshtim me nenin 6 paragrafin 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe mbi këtë bazë ka vendosur të anulojë konkursin e lartë cekur si dhe të shfuqizojë çdo akt tjetër administrativ që rrjedh nga kjo procedurë e rekrutimit, ndërsa ankesa e ankuesit është aprovuar mbi bazën e kësaj të gjeture, ndërsa Kolegji i Këshillit nuk është lëshuar më tej në shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, meqenëse shpallja e konkursit nuk ka qenë në harmoni me dispozitat akteve ligjore të përcaktuara si më lartë.

Nisur nga konstatimet si me lartë, Kolegji duke u bazuar në Nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative konstaton se një procedurë rekrutimi e përfshirë më shkelje të dispozitave materiale konsiderohet procedurë e paligjshme, kështu që me qëllim të vendosjes së ligjshmërisë, Kolegji në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.438/2023, datë 07/04/2023.

Sabile Avdyli

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Vushtrrisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

